



REPUBLIKA E KO SO VËS
Komuna e Drenasit
Drejtoria e Inspektionit
Drenas, më 05.12.2018



RAPORT PËR MUAJIN NËNTOR 2018

Gjatë këtij muaji me rëndësi të veçantë janë realizuar inspektime të subjekteve hoteliere rreth respektimit të Ligjit të duhanit si dhe inspektime të Operatorëve Ekonomik në zbatim të urdhërësive nga Ministria e Tregtisë për largimin nga shitja të artikujve që nuk i plotësojnë kriteret për treg.

Në vazhdim po ju sjell punët e kryera nga secili Inspektor sipas sektorëve të tyre përkatës:

Spektori i Ndërtimit: gjatë këtij muaji kanë inspektuar ndërtimet në Drenas, në veçanti ndërtimet pa leje në zonat e urbanizuara në afërsi të rrugëve regjionale dhe lokale, në zonën e tokës bujqësore nën masën e komosacionit dhe ndërtimet që bëhen në pronë komunale. Gjatë zhvillimit të procedurave, janë hartuar edhe aktvendime për ndërprerje të punimeve, aktvendime për rrënime, urdhëresa për ekzekutime, njoftime dhe përgjigje ndaj kërkesave. Është përcjellur rrënimi i mureve, depove dhe garazhave në pronë publike - me destinim rrugë në Kishnarekë, me datë 30.11.2018.

Spektori i Komunikacionit: ka vazhduar me kontrolla të transportit rrugor dhe largimin e transportuesve, e me rëndësi të veçantë kontrolla të rendit të udhëtimit të kompanive transportuese të liçencuara. Gjatë këtij muaji është vazhduar me masat e radhës gjatë hasjes në transportues ilegal ku janë shqiptuar 2 gjoba mandatore në vlerë prej 100 € (njëqind euro). Gjithashtu janë bërë 3 konfiskime të automjeteve në kohëzgjatje prej 5 ditë të transportuesve ilegal.

Spektori i Sanitarisë: gjatë këtij muaji është vazhduar me kontrollën e subjekteve afariste hoteliere rreth respektimit të Ligjit për kontrollën e duhanit, është mbyllur një lokal për mos mbajtje të higjenes, janë shqyrtuar dy kërkesa të palëve dhe është lëshuar një pëlqim sanitar për barnatore. Që nga fillimi i këtij muaji janë inspektuar edhe qendrat e mjeksësisë familjare në Komunën e Drenasit rreth kushteve higjieniko sanitare, për të cilat do të raportohet në veçanti.

Spektori i Tregut: është vazhduar me kontrollën e tregut javor dhe me largimin e tregtarëve që shesin jashtë lokacionit të tregut në rr.Fehmi dhe Xhevë Lladrovci në ditën e tregut.

Në veçanti janë kryer Inspektime sipas urdhërësive nga MTI për kontrollë të Operatorëve Ekonomik rreth verifikimit nëse në treg gjenden produkte (lodra për fëmijë që nuk i plotësojnë kriteret për shitje dhe rrezikohen konsumatorët), nëse gjenden produkte çaji që janë prodhime kopje e Operatorit Ekonomik “Emona” sh.p.k, si dhe nëse në treg gjenden produkte të cilat kanë etiketen me përmbajtje “Kosovë/o dhe Metohi”, “Kosovo/a-UNMIK” apo “Kosovo/a-Rezoluta 124” apo çdo emërtim tjetër në kundërshtim me emërtimin zyrtar të Republikës së Kosovës. Gjatë këtyre inspektimeve, produktet e gjetura janë evidentuar dhe larguar nga shitja.

Spektori i Ambientit: është vazhduar me inspektime të pronave ku është hedhur material inert sipas kërkesës nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, në të cilat raste pronarët janë urdhëruar për rrafshimin (nivelizimin) e këtij materiali dhe është shqyrtuar një ankesë e palës.

Ka pasur kërkesa për pëlqim në ushtrimin e veprimtarisë dhe kërkesa për leje mjedisore (ku janë dhënë 2 pëlqime në ushtrimin e veprimtarisë dhe janë shqyrtuar 3 kërkesa për LMK nga Komisioni)

Në vazhdim është paraqitur pasqyra e punës në shifra për muajin nëntor 2018:

Lëmia Inspektuese	Procesverbale	Aktvendime	Urdhër ekzekutimi	Gjopa mandatore	Kërkesa për Pëlqim sanitar	Pëlqime Sanitare	Kërkesa	Shqyrtim i kër.	Mbyllje të lokaleve	Konfiskim i targave dhe automjeteve
I.sanitar	26	2		1	1	1			1	
I.Tregut	31	1			2	2	3	3	1	
I.komunikacionit	19			2			1	1		3 A
I.Ndërtimit	23	8	5	1			9	6		
I.Ambientit	7						1	1		
Totali	106	11	5	4	3	3	14	11	2	3

Dhjetor 2018